

ALBANIAN LITERARY CRITICISM (ILUSTRATIVE AUTHORS) KRITIKA LETRARE SHQIPTARE: AUTORË ILUSTRATIVË

ORJELA STAFASANI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dega e Letërsisë
Email: orjela1988@hotmail.com

AKTET VI, 3: 241-244, 2013

PËRMBLEDHJE

Përmes kësaj kumtese synojmë të japim në mënyrë të përgjithshme rrugën e zhvillimit të formave të kritikës letrare shqiptare, për t'u ndalur më detajisht në studimin e veprës në fushë të kritikës letrare të autoriteteve të dëshmuara të kësaj fushe, siç janë; Arshi Pipa, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova dhe Aurel Plasari. Duke ikur nga kritika okazionale e publicistike, e cila ka karakter informues, do të shqyrtojmë monografitë e këtyre autorëve, me vetëdijen se tashmë mund të punohet edhe në drejtim të një teorie të mundshme të kritikës letrare shqiptare. Kumtesa ka si qëllim hetimin se si është bërë kalimi nga kritika e shijes në kritikën si gjykim për veprat dhe fenomenet në letërsinë shqipe. Do të nisemi me kritikën seleksionuese të Pipës, për të vazhduar me leximet historike-letrare të Qosjes. Ndërsa do të merremi edhe me kritikën semiotike të Rugovës dhe me kritikën krahasimtare të Plasarit.

Fjalët çelës: Kritikë seleksionuese, leximet historike-letrare, semiotike, krahasuese

SUMMARY

Anyway, with the help of this work we generally pretend to transmit the development of Albanian literary criticism's forms. It is important to study and to have a general idea above the most distinguished authorities' works of this field such as Arshi Pipa, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova and Aurel Plasari. Leaving the occasional and publicist criticism which has an inform nature, we will analyze the works of these authors, consciously that now we can work of the way of a possible theory of the Albanian literary criticism. The purpose of a work is the analyze how we can judge it as a subjective way means from our point of view and how it is really judge in Albanian literary. Let's begin with selective criticism of Pipa, to historic-literary readings of Qosja. Let's have a collaboration with the semiotic criticism of Rugova, also with the comparative criticism of Plasari.

Key words: selective criticism, historic-literary readings, semiotic, comparative

Ashtu siç është përmendur edhe në përmbledhjen e mësipërme, kumtesa jonë ka si qëllim paraqitjen e rrugës së zhvillimit të formave të kritikës letrare shqiptare. Ne kemi marrë katër autoritete të kritikës letrare shqiptare, por në të vërtetë synojmë që përmes tyre të paraqesim kalimin nga kritika e shijes, në kritikën si gjykim. Duhet theksuar se për secilin autor do të marrim nga një vepër të veçantë, çka do të na ndihmojë të analizojmë diskursin e kritikës veçan për secilin autor, duke kaluar kështu nga një trajtim i përgjithshëm dhe universal në një trajtim

konkret, ku për secilin nga katër autoritetet e lartpërmendura do të nxjerrim konkludimet e nevojshme. Në bazë të kriterit diakronik që ne kemi zgjedhur për këtë kumtesë, trajtimi do të nisë me Arshi Pipën, për të pasuar me Qosjen dhe Rugovën dhe për të përfunduar me Aurel Plasarin.

Me Pipën kritika letrare do të kalojë nga forma okazionale dhe publicistike që ishte deri në atë kohë, në kritikën seleksionuese, çka do të thotë, që në bazë të vlerës, veprat t'i ndash në dy pjesë, në vepra të dështuara dhe në vepra që vlejné.

Por sigurisht që për të seleksionuar veprat në bazë të vlerës, hyn në veprim kritika e shijes. Gjithashtu Pipa tregon se ekziston edhe një tjetër lloj i kritikës dhe ajo është kritika themelore, që merret drejtëpërdrejt me ndërtimin dhe interpretimin e tekstit. Dhe nëse veprat letrare, ose e thënë ndryshe prodhimi letrar, është i mjaftueshëm, atëherë mund të përdoret edhe kritika si gjykim.

Për ta bërë sa më konkret diskursin e kritikës së Pipës kemi zgjedhur tri ese të tij, të përmbledhura në veprën Për Migjenin. Në tri esetë, Historia e dhimbshme e “shpirtit të ri”, Përkujtim i Migjenit dhe Miti i perëndimit në poezinë e Migjenit, hasim të tre llojet e kritikës së tij.

Për dy esetë e para, mund të themi se Pipa bën pak nga të gjitha, ai analizon, interpreton, merret me ndërtimin e poezive të Migjenit, renditjen e tyre, titujt, por duke i lidhur këto në mënyrë të drejtëpërdrejtë me jetën e autorit. Dhe këtu dalim pikërisht te mendimi i Pipës, se ashtu si veprat letrare edhe kritika është diakronike dhe sinkronike.

Por edhe pse Pipa mendonte se si kusht themelor i kritikës duhet të jetë objektiviteti, duhet të themi se në këtë rast ai nuk e zbaton tërësisht këtë, herë herë, dashuria e madhe që ka për Migjenin e bën të mos jetë objektiv dhe nganjëherë gjuha e interpretimit rreket të marrë ngjyrimet poetike dhe kritika të marrë karakter informues, e kjo gjë pohohet edhe prej tij.

Pipa shprehet se ai nuk synon të japë gjykime kritike (eseja Përkujtim i Migjenit)

“Se kritika letrare e vërtetë, e ndritun dhe objektive, nuk mund të kalojë në heshtje të metat e një autori sado e madhe qoftë sympathija e ushqyeme për të”.

Veç për një moment ai tenton të gjykojë Migjenin duke thënë se poezija e tij nuk është një shembull, pasi gjuha e tij nuk është e sigurtë dhe se teknika e shprehjes mungon, por menjëherë kategorikisht sqaron se kjo s’do të thotë të pohosh se poezija e tij nuk është art. Në esenë e tretë, Miti i perëndimit në poezinë e Migjenit, Pipa përgjithësisht është gjykues, përjashtuar pjesën e parë të esesë, kur ai flet për ndikimet në

kulturën shqiptare dhe ndikimet në formimin e Migjenit.

Pipa, më tutje ndalet tërësisht në ndërtimin e veprës, ai heton burimin e stilit të poetit, rimën dhe strofat që ai i përdor edhe pse përdor vargun e lirë. Sigurisht duke mos harruar ndikimet nga gramatika e huaj. Dhe këtu mund të themi se Pipa ndjek parimin themelor të gjykimit kritik, të qenit objektiv.

Në katër autoritetet që ne kemi zgjedhur për trajtimin e temës sonë të kumtesës, mund të themi se diskursi i kritikës së Rexhep Qosjes përbën veçanti, pasi modeli i kritikës së tij, jeton brenda historisë së letërsisë. Tipar dallues në kërkimet e Qosjes është kritika integrale, çka do të thotë se brenda saj ekziston gjithçka, pak biografi e autorit, paraqitje e plotë e veprave të tij, pak interpretim dhe vlerësime letrare e shoqërore. E kjo lloj kritike bën që vepra të marrë trajtën e një monografie. Nga Qosja kemi marrë Porosia e Madhe, një monografi e ndërtuar mbi jetën dhe veprën e Naim Frashërit.

Vepra nis me kronologjinë e jetës së Frashërit, për të kaluar më tej në ndikimet dhe formimin e autorit, e ndërsa ndalet në një prezantim të detajuar të veprave të tij. Por, gjithashtu Qosja merret pjesërisht edhe me ndërtimin dhe interpretimin e veprave të Frashërit, për të dhënë edhe vlerësime letrare, por, gjithmonë këto të lidhura me kontekstin social, që në shumë raste bëhet tipar vlerësues.

Pjesa e gjashtë e monografisë për Frashërin, e titulluar Kritika e krijimtarisë së tij, jep të metat që Qosja heton në krijimtarinë e Frashërit, por, sigurisht që për Qosjen, vlerësimet shoqërore dhe vendi që zë poeti në letërsinë shqipe, është tipar përcaktues për vlerësimin e krijimtarisë së tij.

Me Ibrahim Rugovën, kritika letrare shqiptare njeh zhvillimin e saj më të lartë, përse i përket metodave të kërkimit dhe formave të saj.

“Sprova më e gjerë metakritike në kërkimet shqipe deri më sot është Kahe dhe premise... e Ibrahim Rugovës. Duke identifikuar gjithë prodhimin meta të shkrimit shqiptar me kritikën, Rugova shqyrton tekstat nga ana teorike, por në

rrjedhë të kohës.” (Shala M Kujtim., Letërsia shqipe në katër pamje, Buzuku, Prishtinë 2007) Nga veprat e Rugovës kemi përzgjedhur Veprën e Bogdanit, por kjo sigurisht që nuk është një përzgjedhje sipas rëndësisë. Ne synojmë që përmes kësaj vepre të konkretizojmë, edhe pse në mënyrë të përgjithshme, kritikën semiotike të Ibrahim Rugovës.

Përmes analizës së brendshme dhe leximit të shenjave në tekst, Rugova kërkon mundësinë e aktualizimit dhe të rivështrimit të ideve dhe problemeve të veprës në kontekstet bashkëkohore. Duke u nisur nga kontekstet e teorisë dhe kritikës së sotme, Rugova kërkon rishqyrtim të këtyre ideve. Ai kërkon që leximi i një vepre të madhe, siç është në këtë rast vepra e Bogdanit, të tejkalojë subjektivitetin që të fal madhështia e saj dhe të marrë formën e objektivitetit, që sipas Rugovës kjo është rruga “prej idesë-intuicionit e deri te kritika për veprën”

Rugova kërkon që të forcojë planin sinkronik të studimit të kësaj vepre, duke e bërë atë, objekt të kritikës, të interpretimit dhe të teorisë së letërsisë.

Autori e koncepton veprën në dy pjesë, ku nëse në të parën ai na jep Gjenetikën e Veprës, ku përfshihet vendi që zë Bogdani në letërsinë e vjetër shqipe, biografinë e tij, gjenezën e veprës dhe informacione historiografike, në të dytën, të cilën e titullon Analitika e Veprës, Rugova merret me strukturën kompozicionale të veprës, filozofinë e saj, kohën dhe hapësirën, praktikën teorike-letrare, stilin dhe tipet e ligjëratës etj.

Modernitetin e kësaj vepre, Rugova e kërkon në burimësinë dhe në origjinalitetin e ideve dhe të problemeve universale dhe të përhershme të njeriut e të botës.

Don Kishoti zbret në Shqipëri, është eseja që ne kemi zgjedhur për të bërë sa më konkret diskursin e kritikës së Aurel Plasarit. Kritika e Aurel Plasarit është e pozicionuar si kritikë krahasuese apo kritikë psikanaliste. Plasari, përmes këtyre kërkimeve krahasimtare na jep një pamje të përgjithshme të ideve mbi një vepër të caktuar, në kohë. Te Don Kishoti zbret në Shqipëri, në fillim të esesë, Plasari jep në mënyrë

të zgjeruar situatën historike në Spanjë në kohën kur është shkruajtur kjo vepër, për të kaluar më tej në historikun e ardhjes së Don Kishotit në Shqipëri. Kjo ese përmbledh në vetvete historinë e të gjithë ideve të dhëna mbi këtë vepër. Ai kalon pa ndërprerë nga interpretimet pozitive dhe pezhorative të bëra mbi këtë vepër, te kritika mbi Don Kishotin, duke zgjedhur në të dyja rastet një parim diakronik për paraqitjen e ideve. Kështu, Plasari, duke kërkuar që përmes kritikës krahasuese të na paraqesë një histori të ideve, pozicionohet larg teorisë.

Plasari, në pjesën që flet për përkthimin e Don Kishotit nga Fan Noli, nxjerr mangësitë e këtij përkthimi. Noli, sipas Plasarit, e pozicionon figurën e Don Kishotit në bashkëkohësi dhe i vesh atij tiparet shqiptare, të lidhura sigurisht me situatën historike dhe sociale të Shqipërisë.

Plasari nxjerr pa diskutim të gjitha përftesat e shqipërimin të Nolit, duke nisur nga gjuha popullore, përdorimi i arkaizmave, huazimet orientale, historizmat, antroponimet dhe toponimet, që e bëjnë këtë përkthim të qëndrojnë larg përkthimeve dhe interpretimeve të bëra më parë për këtë vepër.

Mosnjohja e parakushteve historike në të cilat Servantesi ka shkruar Don Kishotin nga Noli, bëhet përcaktuese e marrjes së një tjetër drejtimi të figurës së Don Kishotit.

Konkluzione

Përmes kësaj kumtese, ne paraqitëm në mënyrë të përgjithshme zhvillimin e kritikës letrare shqiptare dhe më konkretisht të metodave të kërkimit, formave dhe zhanreve të kësaj kritike.

Në një shtrirje diakronike, duke u ndalur në monografitë e katër personaliteteve të kritikës letrare shqiptare, siç janë Pipa, Qosja, Rugova dhe Plasari, paraqitëm format e kritikës së tyre.

Me kalimin nga kritika seleksionuese e Pipës, në leximet historike-letrare të Qosjes, për të vazhduar me kritikën semiotike të Ibrahim Rugovës dhe me kritikën krahasimtare të Aurel Plasarit, arritëm paraqitjen e kalimit nga kritika e shijes, në kritikën si gjykim i sistemuar për veprat dhe fenomenet në letërsinë shqipe.

Përmes këtyre personaliteteve të historisë së mendimit kritik letrar shqiptar, mund të themi se

kështu ne mund të punojmë në drejtim të një teorie të mundshme të kritikës letrare shqiptare, sigurisht duke e marrë këtë kontekstualisht dhe me një shpjegim ad hoc për realitetin shqiptar.

Bibliografia

1. Hamiti Sabri, Poetika shqipe: bioletra, tematologjia, albanizma, 55, Tiranë 2010.
2. Shala M Kujtim., Letërsia shqipe në katër pamje, Buzuku, Prishtinë 2007
3. Pipa Arshi, Për Migjenin, PRINCI, Tiranë 2006
4. Plasari Aurel, Don Kishoti zbret në Shqipëri dhe ese të tjera, Naim Frashëri

5. Qosja Rexhep, Porosia e Madhe, monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, Toena, Tiranë 2000

6. Rugova Ibrahim, Vepra e Bogdanit, “8 Nëntori”, Tiranë 1990

7. Rugova Ibrahim, Refuzimi Estetik, Faik Konica, Prishtinë 2005

8. Rugova Ibrahim, Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare, Eurolindja, Tiranë 1996

9. Rugova Ibrahim Kritika, Akademia e Shkencave të Kosovës, Prishtinë 2000..